



Rregulli 3 – Lojtarët: numri i zëvendësimeve

Teksti aktual:

2. Numri i zëvendësimeve

Garat zyrtare

Numri i zëvendësimeve, maksimumi deri në pesë, e cila mund të përdoret në çdo ndeshje të luajtur në konkurim zyrtar do të përcaktohet nga FIFA, Konfederata ose Federata kombëtare përveç garave të meshkujve dhe femrave duke përfshirë klubet si dhe ekipet Kombëtare A, ku maksimumi i zëvendësimeve është tre.

Ndryshimi i përkohshëm:

Organizatorët e garës kanë mundësinë të aplikojnë nga sa vijon:

- *Gjatë ndeshjes, secili ekip:*
 - *mund të përdor një maksimum prej pesë zëvendësimesh*
 - *ka maksimalisht tri ndalesa zëvendësimi**
 - *mund të bëjë zëvendësime në pushimin ndërmjet dy pjesëve (nuk llogaritet si ndalesë zëvendësimi)*
- *Kur luhet kohë shtesë (p.sh. ndeshjet e kupës), secili ekip:*
 - *mund të përdorë një zëvendësim shtesë (një të gjashtë, pavarësisht nëse skuadra ka përdorur numrin maksimal të zëvendësuesve)*
 - *ka një ndalesë shtesë zëvendësimi* (një të katërt, pavarësisht nëse skuadra ka përdorur numrin maksimal të ndalesave të zëvendësimit)*
 - *mund të bëjë zëvendësime shtesë:*
 - *në periudhën para fillimit të kohës shtesë*
 - *në periudhën ndërmjet dy kohëve shtesë*

Nëse një ekip nuk ka përdorur numrin e tij maksimal të zëvendësuesve ose ndalesave të zëvendësimit, zëvendësimet dhe ndalesat e papërdorura mund të përdoren në kohë shtesë.

**Kur të dy ekipet bëjnë një zëvendësim në të njëjtën kohë, kjo do të llogaritet si një mundësi zëvendësimi e përdorur për secilin ekip.*